

VENDIM
Nr. 417, datë 26.6.2024

**PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË
PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 88, datë 6.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35, datë 25.5.2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, sipas strukturave, në të cilat ushtrojnë detyrat funksionale.

2. Elementet e pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për gradë, që përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës. Vlera e pagës për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që u jepet punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, për natyrën e veçantë të punës e të shërbimit që kryejnë, vlerat e së cilës për çdo funksion/pozicion përfitues përcaktohen në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Shtesa mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, që përcaktohet sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Shtesa për vjetërsi në shërbim, që është shtesa që përfiton punonjësi i Gardës së Republikës së Shqipërisë për çdo vit shërbimi. Kjo shtesë aplikohet në përqindje mbi pagën për gradë, të gradës “inspektor” dhe jepet në masën 1 (një) % për çdo vit, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, “vite shërbimi” do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të çdo punonjësi në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Policisë së Burgjeve, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

4. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e vjetërsisë në shërbim për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar dhe fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

6. Vendimi nr. 688, datë 18.11.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

Paga për gradë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë
(Ndryshuar me VKM nr. 88, datë 6.2.2026)

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga për gradë
Për punonjësit e nivelit madhor	Drejtues Madhor	184 500
	Drejtues i lartë	164 000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	138 375
	Drejtues	123 000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	107 625
	Komisar	97 375
	Nënkomisar	88 000
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	83 000
	Inspektor i dytë	78 000
	Inspektor	73 500

Lidhja nr. 2

Masa e shtesës mujore për natyrë të veçantë pune për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë

Nr.	Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë	Masa mujore e shtesës në lekë
1	Drejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë.	40 000
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë.	35 000
3	Shef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	40 000
4	Zëvendësshef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
5	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
6	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Presidentit të Republikës, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
7	Shef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
8	Zëvendësshef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
9	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
10	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryetarit të Kuvendit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	

11	Shef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	30 000
12	Zëvendësshef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit dhe familjes së tij, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
13	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
14	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Kryeministrit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
15	Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit.	
16	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
17	Truprojë dhe truprojë-shofer për zëvendëskryeministrin.	
18	Shef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
19	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të Prokurorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
20	Shef sektori (truprojë), në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	25 000
21	Truprojë, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
22	Truprojë - shofer, në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
23	Shofer (makinë policie), në Sektorin për Sigurinë Fizike të ministrit të Brendshëm, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
24	Shef njësie, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë Speciale.	
25	Zëvendësshef njësie, në Njësinë Speciale.	
26	Specialist për shërbimet, në Njësinë Speciale.	
27	Specialist për stërvitjen dhe trajnimet, në Njësinë Speciale.	
28	Shef sektori në Njësinë Speciale.	
29	Trup shërbimi special në Njësinë Speciale.	20 000
30	Përgjegjës për shërbimin e gatshëm në Njësinë Speciale.	
31	Trup shërbimi - shofer në Njësinë Speciale.	
32	Truprojë dhe truprojë-shofer, për ministrat, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
33	Truprojë dhe truprojë-shofer për SPAK-un, BKH-në dhe GJKKO-në, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
34	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit	
35	Zëvendësdrejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
36	Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
37	Shef njësie në Njësinë e Parë.	
38	Shef njësie në Njësinë e Tretë.	
39	Shef njësie në Njësinë e Katërt.	
40	Shef i Kabinetit. Shef i sigurisë dhe koordinimit në Gardë.	
41	Shef sektori, në Sektorin për sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
42	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
43	Truprojë dhe truprojë-shofer, për personalitetet e tjera shtetërore dhe ish-personalitetet e larta shtetërore, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
44	Shef sektori, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
45	Shef seksioni, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
46	Truprojë dhe truprojë-motoçiklist ceremonial, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
47	Shofer, në Sektorin e Sigurisë së Delegacioneve, në Drejtorinë për Sigurinë e	

	Personaliteteve të Larta Shtetërore.	15 000
48	Zëvendësdrejtor, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
49	Shef sektori, në Sektorin për Sigurinë e drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
50	Zëvendësshef sektori, në Sektorin për Sigurinë e Drejtuesve të SPAK-ut dhe gjykatave, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
51	Truprojë dhe truprojë-shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të tjera të Drejtësisë.	
52	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.	
53	Shef i Qendrës së Aftësimit Profesional.	
54	Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore.	
55	Shef i Sektorit të Buxhet-Financës.	
56	Shef i Sektorit të Analizës.	
57	Shef i Sallës Operative.	
58	Shef i Sektorit të Prokurimeve.	
59	Shef i Sektorit të Informimit të Brendshëm.	
60	Zëvendësshef njësie në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt.	12 000
61	Shofer për kabinetin në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
62	Specialist për formimin dhe trajnimet, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit.	
63	Specialist për qarkullimin rrugor, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit.	
64	Specialist për planifikimin, në Drejtorinë e Planifikimit, dhe Kontrollit.	
65	Specialist për komunikimin dhe statistikën.	
66	Psikolog.	
67	Shofer në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit.	
68	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
69	Specialist për shërbimet e Personaliteteve të Larta Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
70	Specialist për stërvitjen dhe transportin, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
71	Specialist për teknologjinë e informacionit, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
72	Specialist për mjetet lundruese (komandant motoskafi) në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
73	Ndihmësspecialist për mjetet lundruese (marinar) në sektorin e transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
74	Shofer, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
75	Trup shërbimi, në Sektorin për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore, në Drejtorinë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore.	
76	Specialist për shërbimet, në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
77	Shofer në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
78	Trup shërbimi në Drejtorinë për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë.	
79	Specialist për shërbimet dhe trajnimin, në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë.	
80	Shef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt.	
81	Zëvendësshef sektori, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në Njësinë e Katërt.	
82	Shef seksioni, në sektorët në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë dhe në Njësinë e Tretë.	
83	Trup shërbimi në Njësinë e Parë, në Njësinë e Dytë, në Njësinë e Tretë dhe në	

	Sektorin për Sigurinë e Vendvëndosjes së Gardës në Njësinë e Katërt.	
84	Trup shërbimi ceremonial, në të gjitha strukturat.	
85	Asistues për Personalitetet e Larta Shtetërore.	
86	Shef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare.	
87	Zëvendësshef sektori, në Sektorin e Policisë Parlamentare.	
88	Trup shërbimi, në Sektorin e Policisë Parlamentare.	
89	Specialist për shërbimet, në Njësinë e Katërt.	
90	Shef sektori, për ruajtjen e rezidencave qeveritare e OKV-së.	
91	Shofer, në Njësinë e Katërt.	
92	Specialist dhe ndihmësspecialist i ruajtjes nga incidentet me LE dhe ASHM në të gjitha strukturat.	
93	Instruktor për qenin eksplozivkërkues.	
94	Shef sektori, në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës.	
95	Shef sektori, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve.	
96	Shef seksioni, në Sektorin e për Ruajtjen e Rezidencave e OKV-së.	
97	Shef sektori, në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimit Profesional.	
98	Shef sektori, në Sektorin e Ruajtjes së Objektivit, në Qendrën e Aftësimit Profesional.	
99	Shef sektori, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
100	Shef sektori, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
101	Shef sektori, në Sektorin e Protokoll-Arkivit.	
102	Shef sektori (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
103	Specialist (mjek), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
104	Specialist (kryeinfermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
105	Specialist (infermier), në Sektorin e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
106	Specialist, në Sektorin e Analizës.	
107	Specialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm.	
108	Ndihmësspecialist, në Sektorin e Informimit të Brendshëm.	
109	Ndihmësspecialist për shërbimin e brendshëm në të gjitha strukturat.	
110	Specialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës.	
111	Ndihmësspecialist (shofer), në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës.	
112	Llogaritar për armatimin, në Sektorin e Armatimit dhe Pajisjeve.	
113	Teknik mirëmbajtjeje, në Sektorin e armatimit dhe pajisjeve.	
114	Zëvendësshef seksioni, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV-së, në Njësinë e Katërt.	
115	Trup shërbimi dhe shofer, në Sektorin për Ruajtjen e Rezidencave e OKV-së, në Njësinë e Katërt.	
116	Instruktor për palestrën.	
117	Specialist në Sektorin e Programimit dhe Stërvitjes, në Qendrën e Aftësimit Profesional.	
118	Specialist dhe ndihmësspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
119	Specialist i shfrytëzimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
120	Specialist për riparimin e mjeteve, në Sektorin E Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
121	Kolaudator i mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
122	Specialist, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
123	Trup shërbimi në Sektorin e Ruajtjes së Objektivit, në Qendrën e Aftësimit Profesional.	
124	Specialist, në Sallën operative.	

10 000

125	Specialist, në Sektorin e Burimeve Njerëzore.	
126	Specialist, në Sektorin e Buxhet-Financës.	
127	Specialist, në Sektorin e Prokurimeve.	
128	Këshilltar në Kabinet.	
129	Këshilltar juridik në Kabinet.	
130	Asistent në Kabinet.	
131	Asistent për zëvendës drejtorin e Përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.	5 000
132	Përgjegjës material, në të gjitha strukturat.	
133	Ndihmësspecialist për Multimedien.	
134	Teknik ndërtimi, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
135	Teknik mirëmbajtjeje, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
136	Automekanik, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
137	Përgjegjës punëtorie, në Sektorin Logjistik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
138	Ndihmësspecialist i administrimit të mjeteve, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
139	Automekanik, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
140	Specialist arkivi, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
141	Shofer, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	
142	Korrier (shofer), në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.	

Lidhja nr. 3

Masa e shtesës mujore për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë

Nr.	Funksionet organike në strukturat e Gardës së Republikës së Shqipërisë	Masa e shtesës mujore në lekë
1	Ndihmësspecialist në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës. Specialist - motorist automekanik. Përgjegjës VKT-je, elektrikist, elektroaut, baterist, saldator.	3 000
2	Mjek. Kryeinfermier. Infermier.	2 000
3	Arkivist. Protokollist/arkivist.	1 500